



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 484/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkritazi me ankesat e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Malishevë dhe Iniciativa Qytetare për Malishevë (IQM) dega në Malishevë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Malishevë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohen si të pabazuara ankesat e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) me Anr. 484/2013 dega në Malishevë dhe Iniciativës Qytetare (IQM) dega në Malishevë Anr. 528/2013.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 04.11.2013 ka pranuar ankesën, nga subjekti politik LDK dega në Malishevë, në të cilën theksohet se me datën 03.11.2013, në ora 12:09, kemi vërejtur se Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Malishevë Avni Thaqi është i caktuar në fshatin Mirushë – Malishevë. Ky është bërë menaxher i qendrës së votimit QV edhe pse ky është nën hetime për manipulime në zgjedhjet e kaluara. Ky person ka qenë i akuzuar për vjedhje të votave në zgjedhjet e kaluara.

PZAP-i po ashtu me datën 04.11.2013 ka pranuar ankesën Anr 528/2013 nga Iniciativa Qytetare (IQM) dega në Malishevë, pasiqë në qendrën e votimit në fshatin Mirushë, menaxheri i qendrës së votimit është Avni Thaqi i cili është kryetar i nëndegës së PDK-së, për fshatin Mirushë ku i lartpërmenduri akuzohet për manipulime në zgjedhjet e vitit 2009 këtë e konfirmoi Menaxheri i KKZ në Malishevë Rexhep Zogaj dhe pasi ne shprehëm pakënaqësit, ai na citoi në telefon që nuk mund të ma varros.

Në përgjigjen e datës 07.11.2013 të ofruar në PZAP nga KQZ lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit të subjektit politik LDK-së se në Komunën e Malishevës me ANR. 484/13, në bazë të pretendimeve ankimore se menaxheri i qendrës së votimit Avni Thaqi nga subjekti politik PDK është i akuzuar për manipulime në zgjedhjet e mëparshme KQZ ka njoftuar se Avni Thaqi është zëvendësuar në ditën e zgjedhjeve nga KKZ-ja e komunës së Malishevës.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë si dëshmi për shkeljen e pretenduar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesat gjeti se:

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Ankesat janë të pabazuara.

Me nenin 118.4 të LZP-së, parashihet se “ Mund të apelohe vendimet e PZAP-it sikurse PZAP-i, mund ti rishikoj cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar.

Pretendimet ankimore nga ankesat e subjekteve politike Lidhjes Demokratike të Kosovës Dega në Malishevë dhe Iniciativa Qytetare (IQM) dega në Malishevë ku theksohet se janë bërë shkeljet nga ana e anëtarit KKV nga rradhët e subjektit politik PDK-së, Avni Thaqi lidhur me atë se i njejt person ishte i akuzuar për manipulimin në zgjedhjet e vitit 2009, janë të pabazuara pasi që nga shkesa e KQZ-se me nr protokolli 1532/2013 theksohet se Avni Thaqi është zëvendësuar në ditën e zgjedhjeve nga KKZ-ja në Malishevë andaj PZAP-i, në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesen në fjale vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 484/2013 më datën 07.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**



Këshillë Juridike:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda njëzetekatër (orë)orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.